

Vendim nr. 173 datë 13.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare

Fiona Papajorgji, Anëtare

Sonila Bejtja, Anëtare

në datën 13.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (Gj) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GJOVALIN GJETA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 296, datë 12.02.2020; nr. 8, datë 28.01.2021 të Gjykatës Administrative së Apelit; nr. 00-2023-69, datë 19.01.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajftueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Lënia në fuqi të vendimit nr. 703 (80-2018-692), datë 27.02.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 43, 124, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Gjovalin Gjeta (*kërkuesi*) ka ushtruar detyrën e punonjës të rolit bazë (asistent) në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), Peqin. Me anë të shkresës nr. 469 prot., datë 20.04.2010 të drejtorit të IEVP-së, Peqin drejtuar drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve, është propozuar largimi i kërkuesit nga detyra me motivacionin “mosparaqitje në detyrë pa shkaqe të arsyeshme”. Në vijim, drejtori i përgjithshëm i Burgjeve, me urdhrin nr. 4017/1, datë 05.05.2010, ka urdhëruar largimin e kërkuesit nga detyra.

2. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi, përmes së cilës kundërshtohet largimi i tij nga puna. Duke qenë se çështja objekt i këtij ankimi kushtetues individual lidhet me disa procese gjyqësore, Kolegji vlerëson që ato të parashtrohen të ndara.

Procesi i parë gjyqësor

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9204, datë 08.10.2012, ka vendosur anulimin e vendimit nr. 4017/1, datë 05.05.2010 të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve, detyrimin e palës së paditur, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB), t’i paguajë kërkuesit si dëmshpërblim pagën për 12 muaj punë sipas pagës mujore, si dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të pretendimeve.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1821, datë 24.09.2013, ka lënë në fuqi vendimin nr. 9204, datë 08.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Procesi i dytë gjyqësor

5. Kërkuesi i është drejtuar DPB-së me kërkesë për trajtimin e tij me pagesë kalimtare, në zbatim të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 10142/2009*), por nuk ka marrë përgjigje. Në këto kushte, ai i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt pagimin e pagës kalimtare, shpërblimin e menjëhershëm, si dhe atë të dëmit të shkaktuar.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1568, datë 25.03.2015, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë së kërkuesit, që konsiston në detyrimin e DPB-së t’i paguajë atij shpërblimin e menjëhershëm në masën e dy pagave referuese mujore për

periudhën 25.09.2013 deri 25.11.2013, si dhe pagesën kalimtare në masën 50 për qind të pagës referuese mujore për periudhën vijuese 22-mujore. Për sa i përket pjesës së padisë për shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj tij, gjykata e ka rrëzuar atë si të pambështetur në ligj. Ky vendim është ankimuar nga DPB-ja.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2947, datë 27.06.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1568, datë 25.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke pranuar pjesërisht padinë e kërkuarit, që konsiston në detyrimin e DPB-së t'i japë shpërblim të menjëhershëm në masën e dy pagave referuese mujore, si dhe fillimin e trajtimit financiar të kërkuarit me pagesë kalimtare në masën 50% të pagës referuese mujore, në muajin e tretë nga data e nxjerrjes në rezervë ose lirim, por jo më shumë se 24 muaj. Kjo gjykatë ka vendosur rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të pretendimeve, si dhe ka përcaktuar se vendimi i saj përbën titull ekzekutiv e të ekzekutueshëm nga shërbimi përmbartimor.

Procesi i tretë gjyqësor

8. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me palë të paditur DPB-në dhe me objekt saktësimin e pagës mujore, sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 1568, datë 25.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të ndryshuar me vendimin nr. 2947, datë 27.06.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

9. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 703 (80-2018-692), datë 27.02.2018, ka vendosur pranimin e kërkesëpadi, si dhe sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 1568, datë 25.03.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 2947, datë 27.06.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit, duke përcaktuar se me pagë do të kuptohet paga bruto. Kjo gjykatë ka arsyetuar se në bazë të nenit 109 të Kodit të Punës, me pagë kuptohet paga bazë dhe shtesat me karakter të përhershëm, si dhe koncepti pagë përfshin edhe ndalesat për efekt të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore, ndalesat e tatimit mbi të ardhurat apo kur është rasti për sigurim suplementar. Ky vendim është ankimuar nga DPB-ja.

10. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 296, datë 12.02.2020, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 703 (80-2018-692), datë 27.02.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke rrëzuar kërkesën e kërkuarit, me arsyetimin se në rastin konkret nuk bëhet fjalë për pagë në formën e dëmshpërblimit në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjes së punës, por për pagë në formën e sigurimit nga papunësia, që ligji nr. 10142/2009 iu garanton

subjekteve përfituese nga ky ligj mbi ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ky lloj përfitimi jepet mbi bazën e pagës referuese, dhe këtu nuk bëhet fjalë për pagë neto ose bruto, por për një lloj tjetër page, e cila përcaktohet qartësisht në nenin 4 të ligjit nr. 10142/2009 dhe nuk ka vend për interpretim ndryshe gjatë ekzekutimit të vendimit.

11. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Administrative të Apelit, me objekt sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 296, datë 12.02.2020 të Gjykatës Administrative të Apelit.

12. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 8, datë 28.01.2021, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi me arsyetimin se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, të cilit kërkuesi kërkon t’i bëhet sqarimi lidhur me përcaktimin e pagës bruto, është i qartë dhe nuk ka vend për sqarim ose interpretim tjetër, pasi gjykata është shprehur qartë në këtë vendim për llojin e pagës që pala e paditur duhet t’i paguajë atij. Paga referuese përbëhet nga ato elemente që përcakton neni 4 i ligjit nr. 10142/2009. Kundër këtij vendimi, në datën 15.02.2021 kërkuesi ka ushtruar rekurs, përmes të cilit ka kërkuar prishjen e vendimeve nr. 296, datë 12.02.2020 dhe nr. 8, datë 28.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 703 (80-2018-692), datë 27.02.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në vijim, DPB-ja ka ushtruar kundërrkurs.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-69, datë 19.01.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi kundër vendimit nr. 8, datë 28.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, me arsyetimin se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar. Ky kolegji ka vlerësuar, gjithashtu, se shkaqet e ngritura në rekurs lidhen me zgjidhjen në themel të çështjes, me të cilën kërkuesi nuk ka qenë dakord dhe jo me kërkesën për interpretimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykatës*) në datën 01.06.2023 me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve nr. 296, datë 12.02.2020 dhe nr. 8, datë 28.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe nr. 00-2023-69, datë 19.01.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 703 (80-2018-692), datë 27.02.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

II

Pretendimet e kërkuessit

15. Kërkuessi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt gjykimi kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

15.1. *Marrjes së provave*, në aspekt të vlefshmërisë dhe pranueshmërisë së tyre nga gjykatat gjatë proceseve gjyqësore.

15.2. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e ka pranuar rekursin e tij kundër vendimeve nr. 296, datë 12.02.2020 dhe nr. 8, datë 28.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, përmes së cilave është rrëzuar në mënyrë të kundërligjshme dhe antikushtetuese vendimi nr. 703 (80-2018-692), datë 27.02.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku është interpretuar dhe sqaruar se me pagë kuptohet paga bruto.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuessit

16. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuessi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

17. Kolegji vlerëson se kërkuessi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor

ndaj të cilit ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues, për rrjedhojë, si bartës i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt, të pretenduar të cenuar, provon interesin e tij të drejtpërdrejtë.

18. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ajo pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, që ka përmbyllur në themel procesin gjyqësor të iniciuar prej tij. Në këtë situatë Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimeve të kundërshtuara, për rrjedhojë ai e ka përmbushur kriterin e mësipërm.

20. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 19.01.2023, ndërkohë që ankimi kushtetues individual është paraqitur, fillimisht, në Gjykatë në datën 18.05.2023 dhe pas plotësimit të tij është regjistruar në datën 01.06.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

21. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji thekson se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur.

22. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor për sa i përket marrjes së provave, në aspekt të vlefshmërisë dhe pranueshmërisë së tyre nga gjykatat gjatë proceseve gjyqësore, si dhe parimit të sigurisë juridike.

23. Në jurisprudencën kushtetuese është evidentuar dallimi që ekziston midis mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre në procesin gjyqësor. Vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit

gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të kësaj Gjykate, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt ligjor. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrën e marrjes së provave, por jo të vlerësimit të tyre. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë, gjithashtu, në kompetencë të saj. Po ashtu, parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata e zakonshme mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 21, datë 20.03.2017; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për sa më lart, Kolegji konstaton se kërkuesi është mjaftuar vetëm me përmendjen e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor për sa i përket marrjes së provave, por nuk ka paraqitur asnjë argument konkret kushtetues në lidhje me këtë pretendim. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe nuk mund të merret në shqyrtim.

25. Gjithashtu, Kolegji konstaton se kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka pranuar rekursin e tij kundër vendimeve nr. 296, datë 12.02.2020 dhe nr. 8, datë 28.01.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, përmes së cilave është rrëzuar në mënyrë të kundërligjshme dhe antikushtetuese vendimi nr. 703 (80-2018-692), datë 27.02.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku është interpretuar dhe sqaruar se me pagë kuptohet paga bruto.

26. Në lidhje me parimin e sigurisë juridike, Gjykata ka theksuar se në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që nëse gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi jo vetëm që nuk e lidh cenimin e parimit të sigurisë juridike me një vendim të formës së prerë, por nuk ka parashtruar asnjë argument kushtetues se si ky parim është cenuar. Për më tepër, nga përmbajtja e vendimeve objekt shqyrtimi, si dhe nga mënyra se si është parashtruar pretendimi i kërkuesit, ai ka të bëjë me

interpretimin e zbatimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme, çka nuk i përket juridiksionit kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se edhe ky pretendim i kërkuarit nuk është ngritur në nivel kushtetues, për këtë arsye nuk mund të merret në shqyrtim.

28. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.